



**PËRMIRËSIMI I STANDARDEVE
TË PROKURIMIT PUBLIK PËR
TË NGRITUR EFIÇIENCËN
E ENERGJISË NË KOSOVË**

Nëntor 2020

AUTOR:
BALKAN GREEN FOUNDATION

PUBLIKIMI:
NËNTOR 2020

DIZAJNI DHE RRADHITJA:
TOMATO STUDIO

Botim i Balkan Green Foundation (BGF). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit “Promovimi i Energjisë së Gjelbër në Kosovë” i mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Pikëpamjet e hartuesit të këtij dokumenti si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

Implemented by

**balkan
green
foundation**

Supported by



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje	1
2. Hyrje dhe sfondi i temës	2
3. Metodologjia e hulumtimit	5
4. Përvojat e deritanishme në zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë, kontraktimi i produkteve/shërbimeve me performancë të lartë energjetike dhe ESCO-t	6
5. Sfidat në aplikimin e masave të efikasitetit të energjisë në Kosovë	8
5.1. Mos ndarja e përgjegjësisë dhe kompetencave në mënyrë të qartë të institucioneve publike	8
5.2. Mungesa e ekspertëve	9
5.3. Problemet financiare	10
6. Prokurimi i produkteve/shërbimeve me performancë të lartë energjetike	11
6.1 Problematikat të cilat shfaqen në kontraktimin e produkteve apo shërbimeve me performancë të lartë energjetike	12
6.1.1. Përpilimi i specifikacioneve teknike	13
6.1.2. Kriteret e vlerësimit të kontratave	15
6.1.3. Menaxhimi i kontratës	17
7. Kompanitë për shërbime energjetike (ESCO)	18
7.1. Problematikat potenciale në kontraktimin e ESCO-ve	19
7.2. Përfitimet e aplikimit të Partneritetit Publiko Privat	21
7.3. Ligji për Partneritet Publiko Privat	22
7.4. Kontratat model	23
7.5. Thjeshtësimi dhe riorganizimi i procedurave	25
7.6. Prokurimi	26
7.7. Buxheti	26
7.8. Buxheti Publik	27
8. Rekomandime për evitimin e pengesave, strategjia e realizimit dhe implementimit	29
8.1. Ristrukturimi i zyrave dhe përgjegjësitë e tyre	30
8.1.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të përdorimit të efikasitetit të energjisë pranë EME	32
8.1.2. Zyra e Efikasitetit të Energjisë (ZEE)	35
9. Rezime	37
10. Referenca	38

LISTA E SHKURTESAVE

AKEE	Agjencia e Kosovës për Efikasitet të Energjisë
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
BRE	Burime të Ripërtërishme të Energjisë
BGF	Balkan Green Foundation
DBREEB	Divizioni i Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, Efikasitetit dhe Bashkëprodhimit
EE	Efikasiteti i Energjisë
EME	Enti për Mjedis dhe Energji
ESCO	Kompani për Shërbime Energjetike
FKEE	Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
KPE	Kontrata e Performancës së Energjisë
LEE	Ligji për Efikasitet të Energjisë
LPPP	Ligji për Partneritet Publiko-Privat
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
LBP	Ligji për Buxheti Publik
LPEN	Ligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MF	Ministria e Financave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitet të Energjisë
PP	Prokurimi Publik
PPP	Partneriteti Publiko Privat
PRE	Programi i Reformës Ekonomike
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
UA	Udhëzim Administrativ
ZEE	Zyra e Efikasitetit të Energjisë
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

1. Përmbledhje

Me këtë hulumtim synohet rritja e ndërgjegjësimi midis autoriteteve të administratës qendrore dhe lokale, që të ndikojë në ndryshimin dhe zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik për të blerë vetëm produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të lartë të efikasitetit të energjisë, si dhe shtyrja përpara e kontratave të performancës energjetike, duke krijuar një ambient të volitshëm për zhvillimin e ESCO-ve.

Në kuadër të administratës publike të Republikës së Kosovës momentalisht funksionojnë disa institucione të pavarura dhe të integruara në ministri që veprojnë në fushën e efikasitetit të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Me rishkrimin e Ligjit të Efikasitetit të Energjisë, në nëntor të vitit 2018, Kosova ka bërë hapa pozitiv sa i përket kornizës ligjore, në këtë sektor.

Nga hulumtimi (intervistat me persona kyç të këtyre institucioneve, analiza e ligjeve, raporteve etj.) rezultoi se këto institucione jo vetëm që nuk i kanë qartë të definuara detyrat dhe kompetencat, por kanë mungesë të dukshme të stafit profesionist dhe mungesë të mjeteve financiare për përmbushjen e obligimeve të tyre. Edhe pse ekzistojnë shumë ligje në fushën e energjisë, nga përmbajtja e mangët dhe jo precize e tyre, dhe mungesa e ndërlidhjes (mos thirrja e ligjeve në njëri-tjetrin) sidomos i Ligjit për Efikasitet të Energjisë me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjit të Partneritetit Publiko-Privat, nuk ka aplikim konsistent dhe të koordinuar të masave të efikasitetit të energjisë. Si rezultat i kësaj, krijohet pamundësi në implementimin e kompanive për shërbim të energjisë (ESCO) dhe ngecje në arritjen e caqeve dhe obligimeve që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE).



2. Hyrje dhe sfondi i temës

Parakusht themelor i një jete cilësore është që klima mos të pësojë ndryshime të rrezikshme e të pakthyeshme siç po ndodh në këto pesëdhjetë vitet e fundit dhe që ambienti përreth të mbetet i pastër. Djegia e lëndëve djegëse fosile në sektorët e industrisë, trafikut, ndërtesave dhe shërbimeve është shkaktari kryesor i ndryshimeve klimatike në planetin tonë. Aplikimi i pajisjeve efikase, rritja e shfrytëzimit të formave të energjisë së ripërtëritshme dhe minimizimi i atyre fosile, do të ndikonte që të frenohet përkeqësimi i mëturshëm i klimës globale dhe punohej në përmirësimin e saj.

Kosova si pjesë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) ka obligime të cilat duhet t'i përmbushë në sektorin e Efikasitetit të Energjisë (EE). Përveç implementimit të ligjeve, ajo ka edhe caqe të kursimit të cilat duhet t'i arrijë nëpërmjet Planit Kombëtar të Veprimit të Efikasitetit të Energjisë (PKVEE).

PKVEE, sipas Ligjit për Efikasitet të Energjisë (LEE), definojnë dhe përshkruan hapat për arritjen e objektivave të EE duke përfshirë skemën e detyrimeve të EE, masat e politikave të EE, kursimet e energjisë të arritura ose të parashikuara për t'u arritur në nivel të furnizimit, transimit, shpërndarjes dhe konsumit final të energjisë, me qëllim që të arrihen caqet kombëtare të efikasitetit të energjisë. Për më tepër, bën raportimin e progresit për planin paraprak si dhe largon pengesat rregullative dhe jorregullative që mund të hasen në sektorin e efikasitetit të energjisë. PKVEE përpilohet çdo tri vite. PKVEE 2010-2018, është plani i parë afatgjatë dhe paraqet dokumentin e parë kryesor në sektorin e efikasitetit të energjisë në Kosovë. Për çdo tri vite janë hartuar edhe planet afatshkurtra të PKVEE, 2010-2012, 2013-2015 dhe 2016-2018. Ndërsa: "KVEE 2019-2021 do të hartohet sipas Direktivës 2012/27/EU" - Rrezartë Zjaça Dedaj - Zyrtare e lartë për Efikasitet të Energjisë, MEPTINIS.

Dokumentet strategjike të cilat i japin theks të veçantë fuqizimit dhe problematikave të efikasitetit të energjisë në Kosovë janë MSA (Marrëveshja për Stabilizim Asociim) që ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016, Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) dhe Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026. Zbatimi i acquis të energjisë të lidhura me: konkurrencën në tregun e energjisë; ruajtjen e mjedisit; efikasitetin e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë, përbëjnë detyrime serioze që Kosova duhet përmbushur në sektorin e energjisë.

Institucionet publike të cilat merren me politikë-bërjen, implementimin dhe monitorimin e efijencës së energjisë në Kosovë janë MZHE (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, tani e njohur me emrin Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit), respektivisht Departamenti i Burimeve të Ripërtëritshme, Efijencës dhe Bashkëprodhimit, Agjencia e Kosovës për Efijencë të Energjisë (AKEE), Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE), Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) si dhe Zyrat Komunale të Energjisë (ZKE).

Ndërsa ligjet të cilat e rregullojnë sektorin e energjisë në Kosovë janë Ligji i Energjisë Nr. 05/L-081, Ligji për Energji Elektrike Nr. 05/L-085, Ligji i Efijencës së Energjisë 06/L-079, Ligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa 05/L-101 dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 05/L-084.

Kosova ngecë në plotësimin e obligimeve dhe direktivave të BE-së për arsye të ndryshme, si p.sh. prodhimi i energjisë elektrike duke përdorur tejmase burimet fosile nga lëndët djegëse dhe shpenzimi i pakontrolluar i saj, aplikimi i ulët i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe masave të efijencës së energjisë, etj.

Sipas statistikave botërore edhe atyre nacionale të konsumit të energjisë, efijencia e energjisë në përgjithësi, dhe më saktë sektori i ndërtimit, paraqet potencialin më të lartë të kursimit. Për shembull në Kosovë, nga e tërë energjia që shpenzohet, 65-75% shkon në objekte ndërtimi të cilat paraqesin një potencial të lartë të kursimit të energjisë.

Mosshfrytëzimi i këtij potenciali dhe brishtësia e ligjeve të Republikës së Kosovës, dhe fakti se ligjet akoma nuk janë amandamentuar plotësisht që të funksionojnë pa pengesa, ka bërë që Bashkimi Evropian me qëllim që t'i ndihmojë Kosovës në arritjen e caqeve që rrjedhin nga MSA, të shpallë një tender ndërkombëtar në pesë fusha të ndryshme ku njëra nga këto synon ndryshimin e Ligjit të Prokurimit në Kosovë. Në mesin e dymbëdhjetë ofertuesve, projekti është fituar të mbështetet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Pra hulumtimi i pengesave dhe barrierave që vështirësojnë ndërgjegjësimin e au-

toriteteve të administratës qendrore dhe lokale, si dhe të gjitha autoriteteve të tjera publike ose enteve që zbatojnë Ligjin për Prokurim Publik (LPP) për të blerë vetëm produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të lartë të efijencës së energjisë, është synim i këtij punimi.

Projekti për ndryshimin e LPP ka filluar më 10 shkurt 2020 dhe përfundon më 10 shkurt 2023. Ndërsa ndryshimi i Ligjit të Prokurimit Publik, pretendohet të përfundojë në fund të 2020 ose në tre mujorin e parë të vitit 2021.

Pra është një rast i volitshëm që në Ligjin e ri të Prokurimit Publik të eliminohen mangësitë e Ligjit ekzistues dhe të zëvendësohen edhe me propozimet e reja që dalin nga ky hulumtim.

Ky dokument hulumtues si cak hulumtimi ka gjithashtu, arsyet e ngecjes së aplikimit të shërbimeve energjetike, të ashtuquajturat ESCO ose kontrata e performancës së kursimit të energjisë (ESPC) - një model ku një kompani e Shërbimeve të Energjisë (ESCO) arrin kursimin e energjisë në një pronë ose një portofol të pronave si një shërbim. Ky model garanton kursime për një periudhë të caktuar kohe në këmbim të pagesës nga kursimet e kostos së energjisë.

3. Metodologjia e hulumtimit

Për të pasur një vështrim të përgjithshëm të problematikës së sektorit të efijencës së energjisë, BRE dhe asaj të ESCO-ve janë realizuar intervista me persona përgjegjës, udhëheqës dhe bashkëpunëtorë në/të institucioneve që veprojnë në sektorin e energjisë në Kosovë, si: AKEE; FKEE, ZRRrE, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Departamenti i Energjisë (MZhE) dhe një jurist/ekspert i çështjeve të prokurimit (hartues i Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës dhe një nga dy udhëheqësit e projektit të GIZ, për ndryshimin e Ligjit aktual të Prokurimit Publik). Synim tjetër i intervistave është edhe pasqyrimi i veprimtarisë së këtyre institucioneve dhe problemeve që hasin ato gjatë implementimit të masave të EE dhe ESCO-ve.

Intervistat u realizuan në mënyrë virtuale ku i intervistuari shpjegonte veprimtarinë e institucionit, problemet që hasë institucioni në aplikim të masave të EE dhe i përgjigjej pyetjeve të parashtruara nga grupi punues i angazhuar nga BGF. Përgjigjet u regjistruan në shënime, dhe intervistat me pëlqimin e të intervistuarëve gjithashtu u inçizuan në audio format.

Si burime tjera të informatave për studimin e kësaj çështje shërbyen edhe: analiza e Ligjeve ekzistuese në fushën e energjisë dhe shtojcat e këtyre ligjeve, Urdhëresat Administrative (UA), Planet e veprimit (PKVEE dhe PKVBRE), Programi i Reformës Ekonomike (PRE [anglisht: ERP]), raporte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare të organizatave dhe institucioneve të sektorit të energjisë, etj.

Gjatë organizimit të intervistave dhe grumbullimit të të dhënave, jemi ballafaquar me probleme të ndryshme, si: vonesat në komunikim, vonesat në përgjigje nga personat përgjegjës të institucioneve si dhe situata globale e pandemisë e cila ka zvaritur mbarëvajtjen e këtij hulumtimi.



4. Përvojat e deritanishme në zbatimin e masave të efijencës së energjisë, kontraktimi i produkteve/shërbimeve me performancë të lartë energjetike dhe ESCO-t

Gjatë intervistave dhe analizës së ligjeve, udhëzimeve administrative dhe materialeve tjera që na shërbyen si burim i informatave, vërehen një mori problemesh të cilat drejtpërdrejtë ose tërthorazi ndikojnë në mosrealizimin e masave të efijencës së energjisë dhe në mos futjen në jetë të sistemit të ESCO-ve në Kosovë. Natyra e problemeve është e natyrave të shumëllojshme: ligjore, qasjes ndaj punës, e mungesës së resurseve njerëzore, financiare, etj.

Problemet e natyrës ligjore lindin si pasojë e mos harmonizimit të ligjeve, p.sh. Ligji i PP është më i vjetër se Ligji i EE dhe ky ligj nuk përmban nene që thirren në Ligj të Efijencës së Energjisë. Ose p.sh. Ligji i Efijencës së Energjisë nuk është shumë preciz dhe nuk delegon përgjegjësi se cili institucion me cilat kompetenca obligohet.

Mungesa e resurseve njerëzore (e ekspertëve) është një nga problemet kyçe. Si rrjedhojë e mungesës së ekspertëve, specifikacionet teknike të tenderimit janë të mangëta, atyre iu mungon zbatimi, monitorimi dhe kontrollimi kualitativ dhe i pandërprerë i masave dhe shërbimeve të EE, etj.

Mos përcaktimi i saktë i detyrave dhe përgjegjësive të institucioneve që për veprimtari kanë efijencën e energjisë, shkakton huti, punë të dyfishtë të panevojshme dhe ndërhyrje në kompetencat e njëra tjetrës.

Financat po ashtu paraqesin një problem kyç, sepse në mungesë të tyre zvogëlohet numri i projekteve të efijencës së energjisë, si dhe nuk lejohet kompletimi i anëtarëve të stafit të mjaftueshëm të menaxherëve të energjisë nëpër agjenci, ministri dhe komuna.

Shumica e të intervistuarëve duke anashkaluar qëllimisht apo jo qëllimisht problemin e mungesës së ekspertëve, i "shpallin" problemet ligjore (më saktësisht Ligjin e Prokurimit Publik) si problemin themelor të mosrealizimit të masave të efijencës së energjisë me arsyetimin se ky ligj favorizon kriterin e çmimit të lirë dhe jo atij ekonomikisht më të favorshëm.

Gjatë hulumtimit dhe intervistave me ekspertët e fushës së Energjisë vërejmë se Ligji për Prokurimin Publik në fakt nuk favorizon çmimin më të lirë të pajisjes, shërbimit, konsulencës apo ndërtesës. Ligji për Prokurim Publik nuk është pengesa kryesore e realizimit të masave të efijencës, sepse ligji ofron të dy kriteret e vlerësimit të një tenderi: të çmimit më të lirë dhe atij ekonomikisht më të favorshëm.

Andaj, problemi themelor qëndron te mungesa e stafit akademik dhe profesionist në këtë fushë, pra mungesa e njohurive të nevojshme tek përgatitja e specifikacioneve teknike dhe monitorimi i zbatimit të projektit. Mungesa e ekspertëve gjatë hartimit të specifikacioneve teknike shkakton që në shumicën e rasteve, gati 99%, të aplikohet kriteri i çmimit më të lirë, dhe si pasojë që në përpilim të specifikacionit “definohet” kualiteti i dobët i pajisjes, shërbimit apo ndërtesës.

Ndërsa sa i përket ESCO-ve, vërejmë se te shumica e të intervistuarëve me të drejtë është krijuar bindja se pengesa kryesore e mosfunksionimit të ESCO-ve është korniza ekzistuese ligjore, edhe pse në Ligjin për Efijencë të Energjisë, nenin 15, është hartuar korniza ligjore për veprimtarinë e tyre. Shumica thirren në Ligjin e Buxhetit të Kosovës i cili lejon kontrata të natyrës së investimeve kapitale, me kohëzgjatje jo më shumë se 3 vite, gjë që pothuajse automatikisht do të përjashtonte aplikimin e ESCO-ve. Sidoqoftë, ESCO-t mund të implementohen duke u thirrur në Ligjin e Partneritetit Publiko-Privat (LPPP) dhe Ligjin për Efijencë të Energjisë. “Kohëzgjatja e kontratës me LPPP është deri 25 vite, me mundësi vazhdimi për ¼ e kohës” - Ilaz Duli – njëri nga përpiluesit e LPP të Kosovës.

Kontratat ESCO zakonisht zgjasin 5-15 edhe më shumë vite. Ligji për Buxhetin, lejon kontrata të natyrës së investimeve kapitale me kohëzgjatje deri në 3 vite, prandaj LPPP ofron bazë ligjore për implementimin e tyre.

Përvojat e deritanishme tregojnë që problemet e natyrës ligjore nuk rrjedhin vetëm nga Ligji i Prokurimit Publik por edhe nga Ligjet e tjera të fushës së Energjisë që janë në fuqi, si p.sh. Ligji i Energjisë, Ligji për Efijencë të Energjisë dhe Ligji i Performancës Energjetike të Ndërtesave. Problemi themelor qëndron se LPP nuk është amandamentuar pas hyrjes në fuqi të ligjeve të Energjisë dhe si rrjedhojë nuk ka ndërlidhje dhe thirrje reciproke ndërmjet këtyre ligjeve. Projekti i iniciuar nga BE për ndryshimin e Ligjit për Prokurim Publik vjen në përputhshmëri me kohën e këtij hulumtimi i cili mund të ofrojë rekomandime për ligjin e ri.

Në vijim do të përshkruhen në mënyrë të detajuar problemet me të cilat ballafaqohet sektori i efijencës së energjisë në përgjithësi në Kosovë. Pastaj, vazhdohet me sfidat të cilat hasen dhe pengojnë prokurimin e produkteve ose shërbimeve me performancë të lartë energjetike dhe aplikimin e kontratave të performancës së energjisë.

5. Sfidat në aplikimin të efijencës së energjisë në Kosovë

Kosova ka bërë hapa pozitivë në themelimin e kornizës ligjore, por, krijimi i një kornize ligjore nuk është i mjaftueshëm dhe përbën vetëm njërin nga hapat që duhet të plotësohet në mënyrë që të kemi një funksionim të mirëfilltë në sektorin e efijencës së energjisë në Kosovë. Implementimi dhe zbatimi janë thelbësore në mënyrë që të arrihen rezultate pozitive. Sot, fatkeqësisht zbatimi i këtyre hapave në sektorin e efijencës së energjisë në Kosovë është i dobët. Në vijim do të diskutohet për problemet me të cilat ballafaqohet ky sektor të cilat pamundësojnë implementimin dhe zbatimin në nivel të duhur.

5.1. Mos ndarja e përgjegjësisë dhe kompetencave në mënyrë të qartë të institucioneve publike

Kompetencat e përziera, mos definimi i qartë i detyrimeve dhe përgjegjësisë të institucioneve të cilat merren me efijencën e energjisë krijojnë probleme gjatë implementimit dhe monitorimit të projekteve. Sipas udhëheqësit të Agjencionit Kosovar për Efijencë të Energjisë¹, Ligji për Efijencë të Energjisë ka mangësi. Ligji është i koklavitur dhe i paqartë sa i përket delegimit të kompetencave të institucioneve përgjegjëse të cilat merren me efijencën e energjisë në Kosovë. Divizioni i Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, Efijencës dhe Bashkëprodhimit, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), ka detyra kryesisht në politikëbërjen, ndërsa AKEE është përgjegjëse që t'i zbatojë ato. Gjatë intervistave të cilat janë zhvilluar me përfaqësuesit e këtyre dy institucioneve, është theksuar që të dy entitetet kanë përgatitur, implementuar e monitoruar projekte. Në mënyrë që sektori i EE të funksionojë, Ligji për Efijencë të Energjisë duhet t'i definojë dhe shpërndajë në mënyrë të qartë kompetencat e institucioneve përgjegjëse për sektorin e efijencës së energjisë.

Ndërtesat publike përbëjnë një potencial të madh të kursimit të energjisë. Përgjegjësitë për menaxhimin e ndërtesave publike në fushën e energjisë nuk janë qartazi të ndara. Nuk ekziston një institucion i vetëm që merret me menaxhimin e ndërtesave, por në mënyrë të pakoordinuar

1. Arsim Kuliqi, (Maj, 2020), Intervistë nga Balkan Green Foundation

ministrinë dhe komunat menaxhojnë ndërtesat. Në Ligjin për Eficiencë të Energjisë, neni 7 dhe 8 për Renovimin e Ndërtesave Publike, nuk definojnë se cili institucion i ka kompetencat të zbatojë, monitorojë dhe aprovojë ndërtimet e reja të Institucioneve Publike të Kosovës. Këto probleme lindin për shkak që sponzorizimet e ligjeve në fushën e energjisë nuk bëhen nga një institucion i vetëm. Pra, mungon adresa e përbashkët për eficiencë të energjisë. Ligji për Eficiencë të Energjisë është hartuar nga Departamenti i Eficiencës së Energjisë (në kuadër të MEA, ish MZHE) pa konsulencën e AKEE, ndërsa Ligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa (LPEN) është hartuar nga Ministria e atëhershme e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Ligji i Eficiencës së Energjisë duhet që në nenin 7 dhe 8 për Renovimin e Ndërtesave Publike të definojë qartazi se cili institucion i ka kompetencat të zbatojë, monitorojë dhe aprovojë ndërtimet e reja të Institucioneve publike të Kosovës.

5.2. Mungesa e ekspertëve

Mungesa e kuadrove profesionale rezultojnë në zhvillim të dobët të sektorit të eficiencës së energjisë. Kjo ndikon në mos shfrytëzimin e përfitimeve që i sjell ky sektor duke mos aplikuar masat e duhura të eficiencës së energjisë dhe implementimin e trendeve inovative të cilat po ndodhin sidomos me zhvillimin e teknologjisë në sektorin e energjisë. Problemet kryesore me të cilat merret ky hulumtim, pra me prokurimin e pajisjeve eficiente dhe shërbime energjetike, në kapitujt në vijim do shpaloset se këtyre problemeve iu paraprinë edhe mungesa e kuadrove profesionale. Për shembull, përpilimi jo i duhur i specifikacioneve teknike për një produkt, mungesa e informimit rreth trendeve të reja në sektorin e EE, lënja pas dore e mundësisë së kontraktimit të ESCO-ve apo kontratave të performancës së energjisë, shpijnë deri tek blerja e produkteve dhe shërbimeve joeficiente apo mos aplikimi i kriterëve të eficiencës gjatë tenderimit. Institucionet publike, deri më tani, nuk kanë kontraktuar asnjëherë këto lloj shërbime apo kontrata edhe pse Ligji për EE ka krijuar komizën ligjore për kontraktimin e këtyre lloj shërbimeve prapëseprapë mungesa e profesionalizmit dhe ndërgjegjësimi i ulët çojnë në mos aplikimin e këtyre trendeve dhe shfrytëzimin e potencialit që ekziston në këtë sektor.

Problem tjetër është edhe mungesa e resurseve humane. Sipas AKEE,² ky institucion ka pasur mungesë të resurseve njerëzore. Për më tepër, këto probleme shfaqen edhe në zyrat komunale të energjisë. Sipas tij, shpesh koordinatorët e energjisë nëpër komuna, veprimtarinë e menaxherit të energjisë e kryejnë si veprimtari dytësore dhe nuk kanë përgatitje teknike. Shpesh ndodhë që koordinatorët e energjisë edhe pse janë trajnuar nga AKEE, të largohen nga vendi i punës me ndërrimin e kryesisë së komunës.

Bordet dhe drejtorët politikë janë po ashtu pengesë e madhe e realizimit të caqeve, programeve të EE për shkak të vendimeve të gabuara politike dhe joprofesionale. Për të evituar vendimet e gabuara politike dhe jo-profesionale që rrjedhin nga bordet dhe drejtorët politik, propozohet të tillët të zëvendësohen nga organi udhëheqës i institucionit i cili përbëhet nga stafi drejtues profesional i vet institucionit në krye me drejtorin. Rekomandim i cili bazohet në praktikën e suksesshme të institucioneve zvicerane dhe i bazuar në praktikën e pasuksesshme të institucioneve kosovare, ku si anëtarë të bordeve zgjedhën persona me profil politik e jo në cilësinë e ekspertëve të fushës.

5.3. Problemet financiare

Deri më tani sektori i eficiencës së energjisë është ballafaquar me probleme financiare. Mungesa e fondeve ka qenë barrierë që ka penguar realizimin e projekteve dhe masave të EE.

Ministrinë përgjegjëse nuk alokojnë mjete të mjaftueshme financiare dhe pengojnë punësimin e stafit shtesë në zyrat komunale me arsyetimin se ato paraqesin kosto shtesë (Ministria e Financave).

Bazuar nga UA (Udhëzimi Administrativ (09/2017) për zyrat komunale të energjisë, në Nenin 5, të të cilit, nga sasia e detyrave dhe përgjegjësisë që ngarkohet zyrtari komunal për energji, shihet qartazi se këto detyra nuk mund të realizohen nga një person i vetëm.

Me themelimin dhe operimin e Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë do të hapen mundësitë për implementim të projekteve nëpër institucionet publike. FKEE ka filluar financimin nëpër komuna, ndërsa më vonë planifikon të përfshijë edhe sektorët e tjerë. Përveç FKEE-së propozohet që institucionet të kenë në dispozicion më shumë fonde dhe nxitje për investime në masa të EE. Njëjtë, sikur që burimet e ripërtëritshme subvencionohen nëpërmjet tarifave nxitëse (ZRRrE), propozohet që edhe në sektorin e eficiencës së energjisë të ketë subvencionime të tilla dhe të mbulojnë edhe sektorët e amvisërisë, industrisë dhe ato komerciale.

2, Arsim Kuliqi, (Maj, 2020), Intervistë nga Balkan Green Foundation

6. Prokurimi i produkteve/ shërbimeve me performancë të lartë energjetike

Prokurimi publik përbën një ndër shpenzimet më të mëdha të buxhetit të një shteti. Në Kosovë, 30% e buxhetit shpenzohet nëpërmjet prokurimit.³ Andaj, prokurimi publik duhet të jetë i planifikuar dhe organizuar në mënyrë të tillë që kursimi dhe shërbimet të cilat bëhen të jenë nga më të lirat dhe me kualitet më të lartë. Në Kosovë, prokurimi publik është i organizuar në dy nivele, atë lokal dhe qendror. Prokurimi Lokal organizohet nga Komunitet. Ndërsa, Prokurimi Qendror i Kosovës organizohet dhe përbëhet nga: KRPP (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik), OSHP (Organi Shqyrtues i Prokurimit) dhe AQP (Agjencia Qendrore e Prokurimit), të cilat janë në harmoni me standardet e BE-së dhe duhet të veprojnë si të tilla.⁴

Kosova ka lëvizur para në lidhje me prokurimin e produkteve/shërbimeve me performancë të lartë energjetike. Në Ligjin për Eficiencë të Energjisë, neni 9, paragrafi i parë,⁵ në mënyrë eksplicite, përcakton që institucionet publike të cilat zbatojnë Ligjin e Prokurimit Publik qoftë të nivelit qendror apo lokal të blejnë produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të lartë energjetike. Gjatë hulumtimit dhe intervistave me përfaqësues të ndryshëm të institucioneve relevante është vërejtur që në praktikë ky nen nuk po zbatohet. Duke e pasur parasysh që institucionet publike në Kosovë paraqesin një pjesë të madhe të konsumit të energjisë në vend, zbatimi i këtij ligji jo vetëm që do siguronte kursime të larta energjetike, ku paraja publike do të kursehej, por do shërbente edhe si model për sektorin privat. Prandaj, rekomandohet që të krijohet dhe dizajnohet korniza ligjore e rregullative në mënyrë të tillë që i obligon institucionet të zbatojnë këtë nen dhe të përfitojnë nga dobitë e shumta që i sjell aplikimi i masave të EE.

6.1. Problematikat të cilat shfaqen në kontraktimin e produkteve apo shërbimeve me performancë të lartë energjetike

Hapat kryesore që përfshinë procesi i prokurimit gjatë kontraktimit të ndonjë produkti apo shërbimi janë: specifikimi dhe paralogaritja, përgatitja e tenderit, shpallja dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik si dhe menaxhimi i kontratës.⁶ Procedura e prokurimit fillon, me kërkesën e një autoriteti kontraktues (AK)⁷ për ndonjë produkt/shërbim në departamentin e prokurimit. Departamenti i cili e bën kërkesën përpilon specifikacionet teknike dhe bën paralogaritjen e vlerës së projektit. Pastaj, faza e dytë, përgatitja e tenderit, fazë e cila përfshin përgatitjen e dokumentacionit për tender, kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit, publikimin e tenderit, pranimin e ofertave dhe përzgjedhjen e operatorit ekonomik.⁸ Procedura e fundit përfshin menaxhimin e kontratës. Operatori ekonomik gjatë kësaj faze monitorohet dhe kontrollohet gjatë implementimit të projektit duke siguruar që çdo gjë po ekzekutohet sipas marrëveshjes. Gjatë hulumtimit është vërejtur se pothuajse në secilën hallkë të procesit të prokurimit ka pengesa që pamundësojnë blerjen e produkteve/shërbimeve me performancë të lartë energjetike.

3. Raporti i Vjetor i Auditimit 2018

4. Republic of Kosovo. (2016, March). National Programme for Implementation of the Stabilisation and Association Agreement (NPISAA). http://mei-ks.net/repository/docs/3_pkzmsa_miruar nga_kuvendi_final_eng_.pdf

5. Autoritetet dhe organet e administratës qendrore dhe lokale, si dhe të gjitha autoritetet ose subjektet tjera publike që zbatojnë Ligjin për Prokurimin Publik dhe ose FKEE, do të blejnë vetëm produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të lartë të eficiencës së energjisë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ sipas paragrafit 1.3 të nenit 42 të këtij ligji."

6. Udhëzues Operativ për Prokurimin Publik, <https://krpp.rks-gov.net/>

7. AK - Autoritetet Kontraktuese janë institucionet publike si ministritë, komunitet, spitale, shkollat, universitet, ndërmarrjet publike etj.

8. Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, (Janar 2012)

6.1.1. Përpilimi i specifikacioneve teknike

Problemi i mos kontraktimit të produkteve/shërbimeve me EE të lartë fillon në fazën e parë të tenderimit, gjatë përpilimit të specifikacionit teknik nga autoriteti kontraktues. Si pasojë e shpërfilljes së efijencës së energjisë gjatë përpilimit të specifikacioneve teknike kemi produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të varfër energjetike. Parimisht, përpilimi i duhur i specifikacioneve ku masat e EE merren parasysh nuk do të paraqiste ndonjë pengesë për kontraktimin e ndonjë produkti efijent. Mirëpo, mungesa e vetëdijësisht dhe profesionalizmit nga hartuesit e specifikacioneve teknike të institucioneve publike çojnë te përdorimi i produkteve dhe shërbimeve me performancë të dobët energjetike. Gjatë hulumtimit dhe intervistave të zhvilluara me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për EE është vërejtur që mungon strategjia e vendosjes së kufizimeve apo ndalesave për produkte jo efijente. Në mënyrë që të rregullohet kontraktimi i produkteve/shërbimeve me efijencë të lartë energjetike, si hap i parë, rekomandohet, të ndalohet importi i produkteve me efijencë të ulët dhe pa etiketë të efijencës. Kjo jo vetëm që do të stimulonte përdorimin e produkteve efijente por do shërbente edhe si vetëdijësim për institucionet publike e veçanërisht për bizneset e qytetarët, për rëndësinë e aplikimit të masave të efijencës së energjisë.

Rekomandohet, që në Ligjin për Efijencë të Energjisë të përcaktohet strategjia e vendosjes së kufizimeve apo ndalesave për produkte jo efijente. Të rregullohet një nen i veçantë apo UA, që pajiset me efijencë të lartë dhe ato të cilat shfrytëzojnë BRE-të të lirohen nga pagesat e doganave, akcizave dhe obligimeve tatimore. Produktet dhe shërbimet energjetike të cilat ofrohen dhe kontrahohen të lirohen nga taksat ekologjike. AKEE apo ZEE,⁹ të autorizohet sipas LPP, që të përpilojë një listë të produkteve efijente me të cilën çdo prokurim duhet të i referohet kësaj liste, e cila aktualizohet rregullisht. Gjatë intervistës me përfaqësues të MEA-DBREEB,¹⁰ është theksuar se kjo ministri ka propozuar futjen e Prokurimit të Gjelbërt (Green Procurement), ka kërkuar lirime doganore për BRE dhe produkte efijente si dhe Ligji i Prokurimit Publik t'i jep përparësi efijencës. Mirëpo, sipas tyre, meqë Ministria e Financave është sponsorizuese për ligjet që mundësojnë implementimin e këtyre rekomandimeve, nuk ka treguar vullnet për përfshirjen e këtyre sugjerimeve nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Vlen të

theksohet se edhe Direktiva e BE-së kërkon që shtetet duhet të aplikojnë Prokurim të Gjelbërt apo Prokurim të Efijencës së Energjisë. Në Ligjin e Prokurimit Publik mungon Prokurimi i Gjelbërt përkundër kërkesave të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Sipas ekspertit¹¹ në fushën e EE, gjatë grupeve punuese, fillimisht janë vendosur këto nene, por kur është amendamentuar Ligji janë hequr fjalitë dhe nenet ku është përmendur Prokurimi i Gjelbërt (Green Procurement).

Mos harmonizimi ndërmjet Ligjit të Prokurimit Publik dhe Ligjit për Efijencë të Energjisë është një tjetër problem që haset në rast të blerjes së produkteve apo shërbimeve energjetike. Përderisa, organizimi i prokurimit të institucioneve bëhet duke iu nënshtruar LPP, rrjedhimisht, anashkalohet, neni 9 i LEE, që përcakton blerjen nga organet publike. D.m.th., në LPP nuk ka asnjë nen i cili thirret në LEE, për shkak se LEE është hartuar shumë më vonë se LPP. Ligji i Prokurimit Publik nuk është amendamentuar me klauzolat e LEE gjatë ose pas hyrjes në fuqi të LEE. Andaj, propozohet që për çdo produkt/shërbim energjetik, LPP të thirret në LEE. Pra, duke e bërë obligative kontraktimin e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave me performancë të lartë energjetike, ku LPP thirret në LEE, ndërsa në anën tjetër, duke ndaluar importimin e produkteve dhe shërbimeve jo efijente si dhe duke obliguar që për secilin produkt të kemi etiketën e efijencës ashtu edhe siç parashihet në LEE, neni 21,¹² kështu që do të krijoheshin kushtet për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave me efijencë të lartë energjetike.

Për më tepër, rekomandohen edhe dy propozime të tjera gjatë fazës së parë të prokurimit. E para, në LEE të futet një nen i cili specifikon se gjatë përpilimit të specifikacionit teknik, në paralogaritje ekonomike të përfshihen edhe eksternalitetet negative në kuadër të aplikimit të masave të EE, ku përfshihet çmimi i emisioneve (ndotja) dhe imisioneve (ndikimi i ndotjes në ambient, njeri, florë dhe faunë). E dyta, në Ligjin për Efijencën e Energjisë të shtohet një nen që obligon të gjitha institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe lokal të blejnë pajisje efijente nëpërmjet AKEE apo ZEE. Kjo, i përngjan prokurimit të centralizuar apo qendror e cila mund të realizohet edhe nëpërmjet AQP-së. Për shkak të natyrës komplekse të prokurimit të produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave efijente, prokurimi i centralizuar, paraqet padyshim njëhën nga rekomandimet që po praktikohet edhe nga vendet e Bashkimit Evropian. Përvojat e deritanishme në vendet e BE¹³, tregojnë se prokurimi i centralizuar ka rezultuar të jetë shumë i suksesshëm në fushën e EE duke rezultuar në çmime më të lira, kursim në kosto administrative dhe ekspertizë.¹⁴

9. Zyra për Efijencë të Energjisë, definohet në kapitull 6

10. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik - MZHE) - Divizioni i Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, Efijencës dhe Bashkëprodhimit (DBREEB), (Qershor, 2020). Intervistë nga Balkan Green Foundation

11. Avni Sfishta, (Maj, 2020), Interviste nga Balkan Green Foundation

12. Etiketimi i Energjisë, Ligji për Efijencë të Energjisë

13. Public Procurement boosts Energy Efficiency, pro-EE Project

14. https://ec.europa.eu/environment/gpp/pdf/toolkit/module1_factsheet_joint_procurement.pdf

6.1.2.


Kriteret e vlerësimit të kontratave

Problemi i radhës dhe një nga më të rëndësishmet me të cilën ballafaqohet sektori i efijencës së energjisë gjatë prokurimit është përgatitja e tenderit, veçanërisht, kriteret e dhënies së kontratës. Ligji i Prokurimit Publik, neni 60,¹⁵ definojnë dy kriteret për vlerësimin e një projekti në tenderim, kriteri sipas çmimit më të ultë dhe kriteri ekonomikisht më i favorshëm. Vlerësimi i një tenderi sipas kriterit ekonomikisht më të favorshëm, ku për bazë merret kualiteti kundrejt çmimit, është thelbësore për aplikimin e masave të EE. Vlerësimi sipas kriterit të 'Life Cycle Costs' apo metoda e llogaritjes së efikasitetit ekonomik të investimit mungojnë. Këto metoda të cilat i përshtaten më së shumti aplikimit të masave të EE duhet të ndjekin kriterin ekonomikisht më të favorshëm. Për fat të keq, institucionet publike nuk e zbatojnë këtë kriter, andaj jo çuditërisht si pasojë kemi pajisje, shërbime dhe ndërtesa jo efijente. Sipas, KRrPP, gjatë vitit 2018, 99.02% e tenderëve kanë zbatuar kriterin çmimi më i ultë, ndërsa, vetëm 0.98% kanë zbatuar kriterin ekonomikisht më i favorshëm.¹⁶ Sipas ekspertit¹⁷ për prokurim publik, arsyt përse përdoret në përqindje kaq të madhe kriteri i çmimit më të ulët janë: mungesa e ekspertëve për hartimin e specifikacionit teknik, ky kriter është më lehtë për tu përgatitur, vlerësuar dhe numri i ankesave është më i vogël. Ligji i Prokurimit Publik nuk e ka të definuar me nen të posaçëm që produktet që konsumojnë energji duhet të iu nënshtrohen kriterit të projektit më të favorshëm ekonomik, ku theks të veçantë gjatë vlerësimit i jepet 'Life Cycle Costs' dhe kostove eksternale ku përfshihen kostot e emisioneve dhe imisioneve. Andaj, propozohet që në Ligjin e ri të Prokurimit Publik të definohet qartazi që produktet të cilat konsumojnë energji, shërbimet e efijencës së energjisë dhe ndërtimet e reja apo renovimi i ndërtesave duhet të iu nënshtrohen vetëm kriterit ekonomikisht më të favorshëm e jo atij sipas çmimit më të lirë. Pra, në procedurën e tenderimit të pranohen dhe të shqyrtohen vetëm ato specifikacione teknike që përmbajnë këtë kriter, ndërsa ato me kriterin e çmimit më të ulët të refuzohen për kontrollë plotësuese dhe të shqyrtohen pas përmbushjes së specifikacioneve teknike.

Ndërtesat paraqesin një potencial të madh për kursimin e energjisë. Gjatë intervistave, një problem që paraqitet gjatë ndërtimit të ndërtesave të reja apo renovimit të ndërtesave ekzistuese është mos përmbushja e kriterëve minimale për performancë energjetike. Kriteret minimale të ndërtimit të cilat dalin nga udhëzimet administrative në kuadër të Ligjit për Performancë Energjetike në Ndërtesa (LPEN), gjatë përpilimit të specifikacioneve teknike mungojnë dhe nuk zbatohen. Andaj, rekomandohet që gjatë përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit, të verifikohen dhe përcaktohen në kriteret e përzgjedhjes edhe kërkesat minimale për performancë energjetike për ndërtesa duke u bazuar në UA të këtij ligji.

Problemi i radhës që paraqitet gjatë vlerësimit të tenderimit janë komisionet e prokurimit. Përfaqësues të AKEE,¹⁸ theksojnë se anëtarët e komisionit shpesh janë jo kompetent për natyrën e projektit.

Gjithashtu, sipas ligjit dhe rregullores,¹⁹ përpiluesi i specifikacionit teknik, nuk ka të drejtë të jetë anëtarë i komisionit të vlerësimit të tenderit, ngase paraqet "konflikt interesi". Në mënyrë që vlerësimi të jetë profesional, rekomandohet që komisionet për vlerësimin e tenderëve, të përbëhen minimum gjysma nga anëtarë profesionalë dhe ekspertë të fushës. Në komision rekomandohet që mund të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm, dhe njëri nga anëtarët doemos të jetë edhe përpilues i specifikacionit teknik sepse është personi i cili më së miri i ka të qarta specifikacionet e kërkuara teknike.



15. Kriteret për Dhënien e Kontratës

16. Raporti mbi aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2018

17. Ilaz Duli, (Qershor, 2020), Intervistë nga Balkan Green Foundation

18. AKEE, (Maj, 2020), Intervistë nga Balkan Green Foundation

19. Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik

6.1.3. Menaxhimi i kontratës

Menaxhimi i kontratës paraqet fazën e fundit të prokurimit. Në momentin që nënshkruhet marrëveshja e kontratës, përcaktohet menaxheri i projektit.²⁰ Ai apo ajo siguron që projekti po implementohet sipas marrëveshjes. Gjatë intervistës me përfaqësues të AKEE-së, kanë theksuar që njerëz jo kompetent caktohen nëpër projekte si menaxherë të projekteve. Vendosja e njerëzve jo kompetent, të cilët nuk kanë përgatitje profesionale në fushën e energjisë, padyshim që çojnë në monitorim të dobët të projektit dhe rrjedhimisht ndikojnë që aplikimi i masave të EE të mos realizohet ashtu siç është paraparë në projekt. Problemit të monitorimit i shtohet edhe më tepër mungesa e stafit me të cilën ballafaqohet AKEE. Si pasojë e mungesës së resurseve njerëzore shpesh ndodhë që projektet e përfunduara të mos verifikohen dhe kontrollohen tërësisht në detaje. Në mungesë të monitorimit lindin problemet dhe manipulimet e ndryshme gjatë implementimit të projekteve nga operatorët ekonomikë që kanë fituar tenderin. Mbledhja e rezultateve pas implementimit të projekteve, mund të ndihmojë në monitorim dhe verifikim të aplikimit të masave të EE. Për këtë duhet të theksohet platforma për monitorim dhe verifikim të projekteve (MVP) e cila që nga viti 2017 është mundësuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, t'i ndihmojë AKEE dhe komunave që të përcjellin zbatimin e PKVEE dhe planeve komunale për Eficiencë të Energjisë.

Siç u cek, monitorimi paraqet një rëndësi të lartë gjatë prokurimit të produkteve, ndërtimeve apo shërbimeve me performancë të lartë energjetike, andaj, në monitorim duhet të caktohen personat të cilët janë kompetentë dhe të përgatitur profesionalisht në këtë fushë, në mënyrë që implementimi dhe realizimi të jetë i suksesshëm dhe të përfitohet maksimalisht nga aplikimi i masave të EE.

20. Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik

7. Kompanitë për shërbime energjetike (ESCO)

ESCO apo kompanitë për shërbime energjetike janë ato kompani që ofrojnë shërbime energjetike apo masa tjera për përmirësimin e eficiencës së energjisë për konsumatorët, me ç'rast kompania mbartë me vete një pjesë të rrezikut financiar për kryerjen e shërbimeve të ofruara.

Kosova ka bërë një hap pozitiv sa i përket krijimit të kornizës ligjore për kontrata të shërbimeve energjetike (KSE). Në Ligjin për Eficiencë të Energjisë, definojnë qartë kërkesat minimale që duhet t'i përmbajë një kontratë ndërmjet një kompani ESCO dhe një pale tjetër. Këto kërkesa janë në përputhshmëri dhe në harmoni të plotë me Direktivën 2012/27/EU për eficiencë të energjisë, shtojca XIII.²¹

Në planin e dytë të PKVEE (2016-2018), ESCO-t përmenden vetëm në krijimin e kornizave ligjore që duhet të bëhen me Ligjin për Eficiencë të Energjisë, i cili do të nxiste zhvillimin e ESCO-ve.

Në Kosovë, zhvillimi i këtij tregut lë shumë për të dëshiruar. Bazuar në raportin nga BE²², mungesa e njohurive për ESCO dhe përgatitja e dokumenteve administrative dhe të prokurimit për shërbime energjetike, mungesa e kornizave ligjore, mungesa e vullnetit për investime në EE, kanë rezultuar të jenë pengesa kryesore në zhvillimin e ESCO-ve.

Në vijim janë përmbledhur problematikat për zhvillimin e ESCO-ve që janë hasur gjatë këtij hulumtimi.



21. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32012L0027&from=EN>

22. <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/bitstream/JRC104394/kjna28405enn.pdf>

7.1 Problematikat potenciale në kontraktimin e ESCO-ve

Gjatë hulumtimit janë vërejtur një sërë problemesh të natyrave të ngjashme sikurse të ngecja e aplikimit të masave të efijencës së energjisë, të cilat pengojnë aplikimin e kontratave të performancës energjetike (KPE) dhe mos zhvillimin e ESCO-ve. Pra, problemet e natyrës ligjore, të mungesës së ekspertëve, ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësi si dhe ato financiare.

Sikurse në kapitujt tjerë edhe te pjesa e ESCO janë përshkruar problemet dhe janë dhënë propozimet bazuar nga deklaratat e të intervistuarve por edhe nga analiza e ligjeve ekzistuese, udhëzimeve administrative, raporteve të ndryshme, etj.

Edhe pse Ligji për Efijencë të Energjisë dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Efijencë të Energjisë, definojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të qartë aplikimin e ESCO-ve, në Kosovë ende nuk është implementuar ndonjë projekt i tillë. Mos implementimi i projekteve të tilla vie kryesisht si rezultat i kornizës ligjore ekzistuese, mos harmonizimi ndërmjet ligjeve, mungesa e UA, mungesa e ekspertëve për të përpiluar dhe ekzekutuar këto projekte si dhe mungesa e vetëdijesimit nga punonjësit e institucioneve publike rreth mundësive të shfrytëzimit të këtyre shërbimeve apo kontratave. Duhet cekur se nuk ka dyshim që implementimi i një kontrate me performancë energjetike është komplekse, pasi që ngërthen në vete një sërë elementesh si: projektim, prokurim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, shërbim dhe elemente të koncesionit. Andaj, edhe pse institucionet publike ende nuk kanë implementuar një kontratë të tillë, ato duhet të përgatiten paraprakisht duke filluar nga largimi i barrierave ekzistuese ligjore e rregullative, krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për ESCO-t potenciale dhe më e rëndësishmja të nxirren mësimet dhe të merren praktikrat nga vendet në të cilat tanimë veçse përdoren këto lloj kontrata dhe kanë rezultuar të jenë të suksesshme, sidomos nga vendet e Bashkimit Evropian.

Ligji i cili i hapë rrugë kontraktimit të një ESCO-je apo KPE-je është Ligji për Partneritet Publiko Privat, e që njëherazi është edhe forma që përdoret më së shumti edhe nga vendet e Bashkimit Evropian. Përveç modelit PPP, vendet tjera zbatojnë edhe modele të tjera për kontraktimin e KPE-ve, p.sh. Portugalia ka themeluar ligjin e veçantë për kontraktimin e KPE-ve, ku procedurat parashihen sipas ligjit.²³ Në anën tjetër, Franca lejon kontraktimin e KPE-ve nëpërmjet Partneritetit Publiko Privat, por ndalon kontraktimin nëse pagesa e investimit realizohet nga kursimet e arritura.²⁴ Për më tepër, ekzistojnë edhe modele të cilat përdorin konceptin e “crowdfunding”, ku financimi përbëhet nga disa entitete qofshin ato publike apo private, si p.sh.: projekti ‘Prodesa’ në Greqi.²⁵ Megjithatë, si model që shfrytëzohet më së shumti dhe konsiderohet si njëri ndër më të përshtatshmit bazuar edhe në kornizat ekzistuese ligjore në Kosovë është ai nëpërmjet PPP-së.

Në vijim do të përshkruhet rëndësia e aplikimit të PPP për shërbime energjetike dhe sfidat që mund të hasin autoritetet kontraktuese gjatë kontraktimit të kontratave të performancës energjetike nëpërmjet PPP, duke filluar nga korniza ligjore e Ligjit për Partneritet Publiko Privat, pengesat në prokurim, buxhetim, borxh publik, kontratat model dhe procedurat administrative.



23. D2.5 Country Report on Recommendations for Action for Development of EPC Markets, “Transparensa – Increasing Transparency of Energy Service Markets”, supported by the EU program “Intelligent Energy Europe” “Transparensa – Increasing Transparency of Energy Service Markets”

24. <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/bitstream/JRC106625/kjna28602enn.pdf>

25. <https://eurocrowd.org/prodesa/>

7.2. Përfitimet e aplikimit të Partneritetit Publiko Privat

Aplikimi i Partneritetit Publiko Privat për kontraktimin e shërbimeve energjetike është mënyra më efektive për të shfrytëzuar potencialin enorm që ekziston në sektorin publik të eficiencës së energjisë në Kosovë. Përfitimet të cilat vijnë me aplikimin e Partneritetit Publiko Privat janë të shumta. Fillimisht, shteti largohet nga barra për shpenzime në investime kapitale, ku përgjegjësia kalon në palën private. Gjithashtu, Partneriteti Publiko Privat ka shumë avantazhe kundrejt Prokurimit Publik, sepse me të parën shteti investon para ndërsa me të fundit jo. Pra, kursimi i buxheti është tjetër pikë që duhet të konsiderohet, ngase buxheti që planifikohet në investimin e një projekti mund të shfrytëzohet për sektorë apo projekte tjera. Aplikimi i masave të eficiencës së energjisë mund të realizohet me kosto 'zero'.

Të gjitha investimet mund të kryhen duke bërë pagesat e energjisë me të njëjtat kosto derisa kompania rikthen investimet, ndërkohë, përfitimet që shfrytëzohen nga aplikimi i masave të EE janë të menjëhershme duke filluar nga zvogëlimi i kërkesës së energjisë, zvogëlimin e ndotjes, rritjen e sigurisë në furnizim dhe rënie të importit të energjisë e që rrjedhimisht zbrit çmimin e energjisë, e shumë përfitime tjera.

Në Kosovë Partneriteti Publiko Privat shfrytëzohet shumë pak. Zbatohet shumë pak sepse nuk ka informata dhe kjo është njëra nga arsyet pse nuk implementohen shërbimet e Energjisë ESCO. Andaj, duhet të nxitet përdorimi i këtyre kontratave.

7.3. Ligji për Partneritet Publiko Privat

Ligji për Partneritet Publiko Privat nuk e përjashton PPP nëpërmjet ESCO-ve apo KPE-ve. Kjo mund të analizohet nga neni 2, paragrafi 2 i këtij ligji, ku specifikohen ndalesat për PPP si dhe nga neni 7, paragrafi 1, i po këtij ligji, ku lejon Partneritetin Publiko Privat në formë të koncensionit i cili ofron shërbime publike ku merr përsipër përgjegjësinë dhe rrezikun financiar, teknik e operativ, që përshtaten pikërisht me shërbimet të cilat i ofron ESCO-ja. Pengesat fillojnë të dalin në momentin kur në shërbime të ESCO-ve përfshihet edhe ndërtimi i një kapaciteti për gjenerim të energjisë, p.sh. panele solare. Edhe pse, neni 2, paragrafi 1.2 i LPPP-së, përjashton ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese energjetike, në anën tjetër, paragrafi 2.5 e lejon ndërtimin e tyre duke u thirrur në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (LRrE). Sipas Ligjit Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, neni 44, procedura e tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, vlen atëherë kur plotësohet së paku njëri nga dy kushtet. I pari, kur rrezikohet siguria e furnizimit, ndërsa, i dyti, për arritjen e caqeve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, eficiencës dhe mjedisit.

Duke konsideruar, që Kosova ka caqe të cilat duhet të i realizojë në kuadër të burimeve të ripërtëritshme dhe të eficiencës, atëherë, ky nen nuk paraqet problem, kështu duke u krijuar infrastruktura e nevojshme fillestare rregullative për implementimin e KPE-ve nëpërmjet PPP. Në mënyrë që të thjeshtohet dhe të evitohet çdo huti qoftë nga përfaqësues të institucioneve publike relevante apo atyre private, në rast të ndonjë kontraktimi me PPP dhe ESCO, të cilat përfshijnë edhe instalimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, LPPP dhe LRrE të specifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt lejimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike në projektet që si bazë kanë aplikimin e masave të EE.



7.4. Kontratat model

Në mënyrë që të zhvillohet dhe fuqizohet tregu për shërbime energjetike apo ESCO-ve është e domosdoshme që të hartohen kontratat model apo shabllonet për kontraktimin e KPE-ve. Gjatë intervistës,²⁶ është cekur se AKEE ende nuk ka hartuar ndonjë kontratë model për KPE. Ligji për Eficiencë të Energjisë, neni 15, paragrafi 2, specifikon detajisht kërkesat minimale të cilat duhet të i përmbajë një kontratë kur kontraktohet një ESCO apo KPE. Andaj, rekomandohet që Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik) së bashku me akterët e tjerë relevantë, posaçërisht me AKEE, të miratojnë një shabllon specifik të kontratave KPE si akte nënligjore, duke u bazuar në nenin paraprak. Sapo të jenë miratuar modelet e kontratave, të dy palët e interesuara publike dhe ato private janë të detyruara të respektojnë dhe përdorin këto modele kur zbatojnë projektet ESCO-ve. Gjithashtu, neni 15 i LEE-së, paragrafi 3.1 përcakton që të bëhen publikime të praktikave më të mira, udhëzime si dhe kontratat model për KPE. Edhe pse ende nuk është realizuar ndonjë projekt me ESCO, AKEE nuk ka ndërmarrë ndonjë iniciativë për të promovuar ESCO-t, qoftë edhe duke bërë udhëzime apo publikime për praktikatat më të mira për kontraktimin e ESCO-ve.

Në kuadër të praktikave më të mira, gjatë përgatitjeve të kontratave model rekomandohet të krijohen lehtësira për pagesën e TVSH-së nga kompanitë e shërbimeve energjetike. Këto kompani parimisht ofrojnë shërbime ndërsa instalimet e pajisjeve të cilat realizohen në fund të kontratës i kthehen përsëri autoritetit kontraktues. ESCO detyrohet të paguajë TVSH për produktet e tyre në momentin e implementimit të projektit, pra në fillim të periudhës së zbatimit të masave të EE. E kjo mund të shkaktojë vështirësi financiare, sepse ESCO-t përveç investimeve në eficiencë të energjisë do të duhet të financojë edhe TVSH-në, duke rritur investimet kapitale fillestare për ESCO. Kjo mund të zbehë interesimin për investime! Meqenëse ESCO ofron shërbime dhe lëshon fatura në mënyrë periodike partnerit publik gjatë gjithë periudhës së kontratës, atëherë rekomandohet që TVSH-ja të paguhet me secilën nga këto fatura të lëshuara.

Rolin e ESCO-ve mund të e marrë edhe furnizuesi për energji, p.sh. KESCO. KESCO nuk duhet të jetë vetëm furnizues i energjisë por edhe furnizues ose ofrues i shërbimeve të energjisë ku përfshihet edhe shërbimi ESCO – si dhe të ndryshohet statusi nga Ndërmarrje për furnizim me energji në Ndërmarrje për furnizim me shërbime energjetike.



26. AKEE, (Maj, 2020), Intervistë nga Balkan Green Foundation

7.5. Thjeshtësimit dhe riorganizimi i procedurave

Lehtësimit dhe riorganizimi i procedurave administrative krijon një mjedis të favorshëm për kontraktimin e ESCO-ve dhe për investitorët potencialë në këtë fushë. Një marrëveshje me ESCO, përveç që është komplekse, kërkon edhe kyçjen e disa institucioneve. Andaj, një nga pengesat e cila mund të paraqitet gjatë kontraktimit të këtyre projekteve është koordinimi ndërmjet institucioneve. Implementimi i një projekti ESCO, momentalisht kërkon përfshirjen e Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), e cila krijon kornizën ligjore të Eficiencës së Energjisë dhe udhëzimet përkatëse, dhe Ministrinë e Financave (MF), e cila merret me skemat e Partneritetit Publiko-Privat. Meqë modelet ESCO kanë veçoritë e tyre specifike dhe njëherazi paraqesin një fushë të re të punës për Ministrinë e Financave, MEA, AKEE dhe për institucionet e tjera të cilat përfshihen gjatë procedurave të PPP, rekomandohet të ketë koordinim të ngushtë ndërmjet këtyre institucioneve dhe takime të rregullta të përbashkëta disa herë në vit.

Përfshirja e disa institucioneve gjatë procedurave për aprovimin e një projekti me PPP, krijon pengesa administrative dhe parandalon implementimin e këtyre projekteve. Aktualisht, një projekt i vetëm për PPP ka nevojë për aprovim jo vetëm nga subjektet përgjegjëse me ligj, siç janë asambletë komunale, por edhe miratim shtesë nga institucione dhe subjekte të shumta, përfshirë organet e prokurimit publik dhe Ministria e Financave. Propozohet që Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë të shërbejë si pikë kryesore e kontaktit për zhvilluesit ku të gjitha procedurat do të kryheshin në një vend. Lehtësimit dhe riorganizimi i procedurave administrative mund të krijojë një mjedis që tërheq investime.



7.6. Prokurimi

Njëra ndër sfidat me të cilat ballafaqohen autoritetet kontraktuese është se në cilin lloj të kontratës kategorizohet prokurimi i ESCO-ve. Meqë ESCO-t bëjnë dizajnimin teknik, instalimin, operimin, mirëmbajtje dhe shërbimin, atëherë kemi të bëjmë njëkohësisht me disa lloje të kontratave. Kjo luan një rol tepër të rëndësishëm ngase varësisht nga lloji dhe vlera e kontratës zbatohen procedurat e caktuara (p.sh. Kontratat publike kornizë nuk lejojnë kontrata me kohëzgjatje më tepër se 36 muaj).²⁷

Përzgjedhja e një Partneriteti Publiko-Privat bëhet duke u thirrur në Ligjin për Prokurimin Publik.²⁸ Problemi që mund të shfaqet gjatë kontraktimit të një ESCO-je është mungesa e metodologjisë së vlerësimit të ofertave. Në këtë mënyrë, Ligji për Prokurim Publik duhet të definojë forma të veçanta të prokurimit për shërbimet e energjisë, ku specifikohet mundësia e kontraktimit të ESCO-ve, të hartohet metodologjia për vlerësimin e ofertave si dhe të delegojë implementimin e ESCO-ve sipas LPPP. AKEE apo MEA (Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit) duhet të krijojë një metodologji që përcakton vlerën e projektit ku si kriter merren kostot e ciklit jetësor apo raporti 'çmim-performancë' si dhe vlerësohen të ardhurat nga kursimet e energjisë të projektit ESCO. Pas hartimit, kjo metodë duhet të zbatohet dhe respektohet nga të gjitha autoritetet përkatëse, gjatë vlerësimit të projekteve në lidhje me ESCO-t.

7.7. Buxhetimi

Pengesa e radhës e cila mund të paraqet problem gjatë lidhjes së një kontrate të performancës së energjisë është kohëzgjatja e tyre. Këto kontrata zakonisht zgjasin 5-15 vite. Ligji për Buxhetin lejon kontrata të natyrës së investimeve kapitale me kohëzgjatje deri në 3 vite. Për kontrata më të gjata duhet aprovim nga qeveria.²⁹ Kjo pengon nënshkrimin e kontratave shumëvjeçare. Për kontratat ESCO, kjo kohëzgjatje është shumë e shkurtë pasi që ato kërkojnë disa vite që me kursim të energjisë të amortizohen investimet e tyre. Prandaj, në parim kërkohet ndryshimi në Ligjin e Buxhetit, që nuk pengon lidhjen e marrëveshjeve afatgjate për shërbime energjetike. Mirëpo, në anën tjetër, nëse marrëveshjet me ESCO konsiderohen si shërbime atëherë kjo bën pjesë në investime të planifikuara vjetore për autoritetet publike. Kësisoj, Ligji për Buxhet nuk paraqet pengesë ngase nuk kemi të bëjmë me investime kapitale por vetëm me kontraktim të shërbimeve.

27. How to Procure (Complex) Energy Efficiency Services A Guide for Contracting Authorities and ESCOs, International Energy Agency - IA Demand Side Management (DSM)

28. Ligji për Partneritetin Publiko Privat, Neni 8

29. Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020, Neni 12, Limitet në zotime dhe shpenzime, paragrafi 8

7.8. Borxhi Publik

Borxhi publik paraqet një ndër pengesat kryesore që vështirësojnë kontraktimin e kompanive për shërbime energjetike. Në momentin që një autoritet publik nënshkruan kontratë për implementimin e një projekti, kjo kontratë i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Ligjit për Borxhet Publike. Problemi këtu lindë, ngase se totali i pagesave që duhet të i realizojë autoriteti publik ndaj ESCO-së do llogaritet si një borxh total i vetëm. Nuk merret në konsideratë fakti që po këto pagesa bëjnë pjesë në kategorinë e shpenzimeve operative, ku bëjnë pjesë si pagesa e energjisë elektrike, uji etj. Vlera e kësaj pagese e cila realizohet ka të njëjtën vlerë si para ashtu edhe pas investimit, vetëm se pas investimit sasia e kursimit të energjisë që arrihet në vlera monetare shkon në llogari të kompanisë për kthim të investimeve. Mënyra se si definohet borxhi publik për rastet kur kontraktohen kompanitë për shërbime energjetike duhet të ndryshohet.

Ligji për Eficiencë të Energjisë krijon pengesa në kontraktimin e kompanive për shërbime të energjisë. Ky ligj është supozuar të definojë qartë se kontratat e performancës së energjisë të mos konsiderohen borxhe publike dhe të kenë harmonizim me ligjet e lartcekura dhe Ligjin për Prokurim Publik. Sipas nenit 37,³⁰ paragrafi 7, marrëveshjet për Shërbime të Energjisë janë marrëveshje të cilat nuk konsiderohen borxhe publike. Këto marrëveshje definohen në LEE, si marrëveshje ndërmjet një autoriteti kontraktues dhe Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Rrjedhimisht, të gjitha kontratat e performancës së energjisë apo kompanitë të cilat ofrojnë këto shërbime përjashtohen nga ky nen. Kështu autoritetet kontraktuese bëhen palë detyruese duke iu nënshtruar dispozitave sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike. Propozohet që kontratat e performancës së energjisë, njësoj sikurse marrëveshjet për shërbime të energjisë sipas nenit 37, të mos konsiderohen borxhe publike. Ky ndryshim mund të konsiderohet si njëra ndër shtytjet më të mëdha për fuqizimin e kontratave të performancës së energjisë dhe në fuqizimin e sektorit të eficiencës së energjisë në sektorin publik. Kjo pasi që institucionet publike nuk do të hezitonin për aplikimin e masave të eficiencës së energjisë duke mos u ndjerë të obliguar për shkak të borxheve publike.



30. Ligji për Eficiencë të Energjisë, Marrëveshjet për Shërbime Energjetike

8. Rekomandime për evitimin e pengesave, strategjia e realizimit dhe implementimit

Në kapitujt e mësipërm janë renditur në mënyrë të detajuar një sërë problemesh të cilat dalin nga natyra ligjore e rregullative, mos ndarja e kompetencave, mungesa e stafit profesional, mungesa e financave, mungesa e përgjegjësisë ndaj punës, etj. Këto pengojnë në mos shfrytëzimin e përfitimeve enorme që mund t'i sjellë aplikimi i masave të efijencës së energjisë dhe kontraktimin e shërbimeve inovative si zbatimit të kontraktimit të produkteve efijente apo kompanive të cilat ofrojnë shërbime energjetike nëpërmjet kontratave të performancës energjetike.

Në mënyrë që të evitohen problemet e lartcekura, në vijim propozohet dhe rekomandohet themelimi apo shkrirja e institucioneve (zyrave) ekzistuese në dy institucione themelore. Njëri do të merret ekskluzivisht me hartimin, monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të ligjeve ekzistuese të fushës së Energjisë (në vijim do të quhet Enti për Mjedis dhe Energji - EME), ndërsa institucioni tjetër do të ketë karakter ekzekutues, këshillues dhe zbatues të masave të EE, duke respektuar ligjet që hartohen nga Institucioni i parë, (në vijim do të quhet Zyra për Efijencë të Energjisë - ZEE).



8.1. Ristrukturimi i zyrave dhe përgjegjësitë e tyre

Realizimi dhe implementimi i propozimeve për eliminimin e pengesave që janë cekur, mendohet të arrihen:

1. Me ndarjen e qartë të përgjegjësisë dhe kompetencave të zyrave të reja që si rezultat i hulumtimit propozohen të themelohen, dhe
2. Me ndryshimin e Ligjit të Prokurimit Publik dhe amandamentimit të pjesërisht të LEE, LPPP dhe Ligjit të Rregullatorit të Energjisë - që mos të jenë bartës të pengesave të aplikimit të masave të efijencës së energjisë.

Kompetencat dhe detyrat e institucioneve ekzistuese shpesh përputhen apo bien ndesh me njëra tjetrën, duke i ndërhyrë njëra tjetrës në kompetenca, po ashtu krijohen 'veprimtari paralele' të njëjta, të tepërta dhe të panevojshme, ose huti se cili institucion është përgjegjës.

Pra propozohet ristrukturimi i institucioneve ekzistuese si: Departamentit të Energjisë, Inspektoratit të Energjisë, AKEE dhe FKEE duke themeluar dy institucione me unifikimin e pjesërisht të atyre ekzistuese, dhe duke i ndarë qartazi detyrat dhe kompetencat në baza ligjore. Njëri ka karakter ligjdhënës dhe tjetri ekzekutues.

Njëri institucion do të propozojë, hartojë ligje, monitorojë dhe sigurojë aplikimin e këtyre ligjeve, të cilat janë gjithëpërfshirëse dhe zbatohen nga të gjitha autoritetet publike dhe nga sektori privat, përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve të energjisë.

Për kryerjen e këtyre veprimtarive pa pengesa propozohet që të rritet numri i stafit profesional, me arkitektë, inxhinierë dhe auditorë të energjisë.

Mendohet që ky institucion si sektor i veçantë i energjisë të futet nën ombrellën e një institucioni më të lartë që nuk merret vetëm me problematikat e energjisë, por si pjesë e tij janë edhe sektorët që kanë të bëjnë me ruajtjen e mjedisit, si p.sh.: mbrojtja e ujit, largimi i ujërave të zeza, administrimi i mbeturinave, ripërtërimi i vendeve të kontaminuara, mbrojtja nga zhurma dhe sektorë tjerë të rëndësishëm për ruajtjen e mjedisit. Në vijim do ta quajmë Enti për Mjedis dhe Energji (EME).

Ndërsa institucioni tjetër është i pavarur, qendror dhe merret vetëm me ndërtesat publike (niveli qendror dhe lokal) dhe me karakter ekzekutues i cili i nënshtrohet ligjeve ekzistuese të cilat hartohen nga Enti ligjdhënës, pra nga Enti për Mjedis dhe Energji (EME). Në vijim këtë institucion do ta quajmë si Zyra për Efijencë të Energjisë (ZEE).

Në figurën vijuese është paraqitur grafikisht struktura e EME ndërsa në figurën 2, detyrat dhe përgjegjësitë e të dyjave:

Figura 1 - Struktura e Entit për Mjedis dhe Energji (EME)




Figura 2 - Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Energjisë të EME dhe Zyrës për Eficiencë të Energjisë (ZEE)

ENTI PËR MJEDIS DHE ENERGJI -Sektori i përdorimit eficient të energjisë	ZYRA PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJES (ZEE)
<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Energjisë • Inspektorati i Energjisë • AKEE (Sektori për Planifikim dhe Sektori për Promovim dhe Zhvillim të Projekteve) 	<ul style="list-style-type: none"> • FKEE • AKEE (Sektori për Monitorim dhe Raportim)
<ul style="list-style-type: none"> • Karakter legjislativ • Hartimi i politikave • Hartimi i ligjeve dhe UA, monitorimi dhe implementimi • Planifikimi për furnizim me energji • Sigurimi i fondeve për EE • Të adaptojë legjislacionin për implementimin e ESCOve • Të hartojë modelin e kontratave ESCO (EPC & ESC) • Informimin e popullsisë mbi politikat mjedisore dhe energjetike • Fushata promovuese për vetëdijësimin e popullsisë • Etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Karakter ekzekutues • Zbatimi i masave të EE • Konsulenca teknike • Mbështetje profesionale • Monitorimi i masave të EE raportimi • Përpilimi i dokumentacionit teknik për prokurim • Të ofrojë shërbime ESCO dhe të angazhojë ESCO private • Inventarizimi i pajisjeve eficiente • Menaxhimi i softuer për menaxhimin e energjisë së ndërtesave • Etj.

8.1.1.

Detyrat dhe përgjegjësitë e sektorit të përdorimit eficient të energjisë pranë EME

Sa i përket sektorit të Energjisë, sipas përshkrimeve të deritanishme të detyrave dhe përgjegjësiave të institucioneve ekzistuese (në ligje dhe uebfaqet e tyre), hulumtimeve nga intervistat, dhe përvojat e të intervistuarve, ky sektor duhet të përmbajë një bashkëdyzim të detyrave dhe përgjegjësiave të AKKE dhe Departamentit të Energjisë. Ky ent duhet të jetë përgjegjës për të dy sektorët, atë publik dhe privat dhe duhet të përfshijë detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit dhe Inspektoratit të Energjisë dhe disa përgjegjësi të AKEE (d.m.th përgjegjësitë legjislative të AKEE, p.sh. Sektori për Planifikim dhe Sektori për Promovim dhe Zhvillim të Projekteve), edhe të ketë këto synime dhe aktivitete.

SYNIMET

1. Hartimi i politikave.
2. Të sponzorojë, hartojë dhe amandamentojë ligje dhe udhëzime administrative.
3. Të monitorojë dhe kontrollojë implementimin e ligjeve.
4. Të kërkojë nga ministria përgjegjëse të alokojë fonde të mjaftueshme financiare për plotësimin e stafit profesional në këto dy institucione të reja dhe në komuna (koordinatorët e energjisë).
5. Të organizojë trajnimet e vazhdueshme të stafit të lartpërmendur.
6. Të kërkojë nga komunat që menaxherët e energjisë së komunave të mos kryejnë veprimtari të tjera.
7. Pozita e menaxherit të energjisë të mos jetë pozitive e varur nga politika ditore por profesionale, dhe e përhershme.
8. Të iu ndihmojnë komunave në përpilimin planit të veprimit të komunave, dhe ato të jenë sa më precize dhe reale, që ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për një analizë të mirëfilltë në fushën e eficiencës së energjisë - e jo voluminoze.

9. Të jetë zyra e kontaktit të parë me donatorët financiarë ndërkombëtarë.
10. Të mbikëqyrin koordinimin në mes të donatorëve ndërkombëtarë dhe institucioneve përgjegjëse të Kosovës dhe t'i delegojë donacionet në institucionet përgjegjëse për aplikimin e masave të EE.
11. Të sigurojnë fonde për mjetet financiare të zbatimit të masave dhe këto fonde të përfshihen me nene të posaçme në Ligjin e Energjisë. P.sh. çdo konsumues i energjisë elektrike të paguajë 3-4% nga shuma e faturës së energjisë në këtë fond, i cili pastaj do shfrytëzohet si burim financiar për subvencionim të masave për efikasitet të energjisë për sektorin publik dhe privat.
12. Të promovojnë sistemet e ngrohjes dashamirëse ndaj mjedisit (ngrohje nga BRE-të).
13. Të jenë të përkushtuar dhe të sigurojnë që në furnizimin me energji elektrike në Kosovë të rritet pjesëmarrja e pajisjeve që shfrytëzojnë BRE.
14. Të promovojnë dhe mbështesin renovimin ose zëvendësimin e ndërtesave të vjetra me konsum të lartë të energjisë.
15. Të bëjnë kontrollin e dokumentacionit të ndërtimit (pjesa e energjisë) dhe të japin pëlqimin për ndërtim në bazë të specifikacionit të dorëzuar.
16. Ky pëlqim të jetë komponentë e lejes së ndërtimit.
17. Të sigurojnë që ndërtesat publike të arrijnë një standard më të lartë të energjisë.
18. Të adaptojnë legjislacionin për implementimin e ESCO-ve.
19. Të hartojë modelin e kontratave ESCO (EPC & ESC).
20. Të promovojë elektromobilitetin. p.sh. për pronarët e objekteve që furnizohen me rrymë nga panelet Fotovoltaike.
21. Të ndikojnë te politikbërësit për ndalimin e qarkullimit të makinave Diesel në të ardhmen e shkurtër.

AKTIVITETET-MASAT:

1. Të mbështesin pronarët e ndërtesave (shtëpive) në zëvendësimin e sistemeve të ngrohjes fosile me sisteme të ripërtëritshme të ngrohjes.
2. Të zhvillojnë planifikimin hapësinor dhe kohor të furnizimit me energji në formën e një plani republikan të energjisë. Për shembull, krijimi i strategjisë kombëtare për furnizim me energji për shembull, për periudhën deri më 2050. Kjo strategji do të përfshinte skenarë me caqe të ndryshme të furnizimit, p.sh. rritja e efikasitetit, aplikimi i shpeshtuar i BRE (kërkimi i zonave të përshtatshme për aplikimin dhe instalimin e pajisjeve të BRE), largimi hap pas hapi nga furnizimi me energji fosile (thëngjill) etj.
3. Të gjitha projektet e reja të ndërtimit dhe renovimit në nivelin qendror dhe lokal të zbatojnë udhëzimet në lidhje me kërkesat e rritura të efikasitetit të energjisë. Të shqyrtojnë, kontrollojnë të gjitha projektet e reja të ndërtimit dhe renovimit në sektorin publik dhe privat, dhe dokumentacioni (formulari) i lëshuar nga ky institucion të jetë pjesë e lejes së ndërtimit.
4. Dokumentacioni - të hartojë një formular në të cilin jepen dhe dëshmohen të gjitha masat e parapara për ndërtime të reja dhe renovime energjetike që respektojnë kriteret e Udhëzimeve Administrative të Ligjeve në fuqi. Për shembull, me këtë formularë dëshmohet se ndërtesa e re apo e renovuar respekton normat dhe kriteret e Rregullores MMPH Nr 04/18j për kërkesat minimale të Performancës Energjetike të Ndërtesave / Vlerat U (W/m2K) sipas Tabelës 1 dhe 2. Nëse pas kontrollit të formularit nga Institucioni i ri (EME) dëshmohet se objekti përmbush kriteret, atëherë lëshohet formulari për kompletimin e dokumentacionit të lejes së ndërtimit.
5. Të kryejnë fushata (aksione) të ndryshme promovuese për ndërgjegjësimin e popullsisë për të kursyer energji.
6. Të ofrojnë informacione mbi politikën mjedisore dhe energjetike të Kosovës.
7. Të informojnë dhe sensibilizojnë qytetarët mbi përfitimet nga masat efikase.
8. Të hartojnë statistikën e energjisë në bashkëpunim me ZEE dhe monitorojnë arritjen e objektivave mjedisore dhe raportojnë tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.
9. Të ndikojnë te politikbërësit që pajisjet me efikasitet të lartë të lirohen nga dogana apo TVSH-ja.
10. Të ketë kompetenca ligjore që të ndalojnë aplikimin, qarkullimin dhe implementimin e pajisjeve jo efikase (makinat, pajisjet shtëpiake, ndriçimit, elektronikës etj.).
11. Të identifikojnë barrierat rregullative dhe jorregullative që pengojnë kontraktimin e ESCO-ve.

8.1.2.

Zyra e Eficiencës së Energjisë (ZEE)

Ndërsa institucioni tjetër Zyra për Eficiencë të Energjisë (ZEE) duhet të jetë i pavarur nga EME dhe nuk është e domosdoshme të jetë në të njëjtën ministri. Do të ofrojë mbështetje profesionale, konsultative dhe teknike vetëm për administratën publike dhe zbaton detyrimet dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji i Eficiencës së Energjisë, Ligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa, Ligji për Energjinë dhe Ligji për Energjinë Termike dhe i cili do mbikëqyrej nga institucioni i lartpërmendur.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni duhet të jenë si në vijim:

1. Përfshinë detyrat dhe përgjegjësitë e FKEE dhe disa përgjegjësi të AKEE, (ekzekutive) në implementimin e masave të EE.
2. Organ qendror ekzekutues, konsulent, monitorues dhe raportues i masave të EE.
3. Përgjegjës për menaxhimin e ndërtesave publike në fushën e energjisë.
4. Krijon strategjitë afatshkurta dhe afatgjata të aplikimit të masave të EE, si p.sh. renovimit të ndërtesave, blerjes së pajisjeve eficiente (ndriçimi) etj.
5. Gjitha institucionet (qendrore dhe lokale) para se të aplikojnë masat e EE (furnizim me materiale eficiente, shërbime ose ndërtime apo renovime të ndërtesave) duhet të këshillohen paraprakisht me ZEE dhe janë të obliguara të zbatojnë masat që i propozon ZEE apo të blejnë nëpërmjet ZEE-së.
6. Përpilimin e një inventari me pajisje me eficiencë të lartë.
7. Përpilimi i specifikacionit teknik profesional për Prokurim duke respektuar kriteret dhe normat që dalin nga Udhëzimet Administrative të Ligjit për Eficiencë të Energjisë, të Ligjit të Performancës Energjetike të Ndërtesave, të Ligjit të Energjisë etj., dhe duke ofruar pajisje nga inventari i pajisjeve efikase.
8. Pjesëmarrja e përpiluesit të specifikacionit teknik në komisionin e Prokurimit.
9. Mbikëqyrja profesionale dhe monitorimi gjatë ekzekutimit të masave të EE si p.sh. renovimit të ndërtesave publike, blerja e pajisjeve eficiente, ofrimi i shërbimeve konsulencë.
10. Kontrollimi i operatorëve ekonomik që të mos devijojnë nga specifikacioni teknik gjatë implementimit të projektit, (në bazë të Platformës për Monitorim dhe Verifikim të Projekteve - projekt i Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.
11. Instalimi i obliguar i njehsorëve (matësve) të energjisë termike në objektet e reja.

12. Të bëjnë mbledhjen e rezultateve pas përfundimit të projekteve dhe të verifikojnë dhe të kontrollojnë suksesin e implementimit të masave të Eficiencës së Energjisë.

13. Krijimi dhe mirëmbajtja e një baze të dhënash për gjitha ndërtesat e administratës publike (qendrore dhe lokale) që përmban shpenzimin e energjisë elektrike, termike dhe ujit, dhe sipërfaqen e ndërtesave. Menaxhimi i kësaj baze të bëhet në bashkëpunim me të gjitha ministrinë dhe komunat.

14. Bashkëpunimi intenziv me koordinatoret komunalë të energjisë. T'i obligojë këta t'i menaxhojnë dhe aktualizojnë vazhdimisht (mundësisht në baza mujore) të dhënat statistikore mbi konsumin e energjisë në komuna në një platformë të përbashkët me ZEE (p.sh. Software ENMASOFT i GIZ-it). Me këtë program bëhet menaxhimi i energjisë dhe kalkulimi i shpenzimeve në ndërtesa.

15. Hartimi i një inventari të pajisjeve eficiente (pajisjeve shtëpiake, ndriçimit, elektronikës, makinave etj.) me të cilat ekskluzivisht duhet të pajisen zyrat e administratës publike (niveli qendror dhe lokal).

16. Çdo produkt duhet të ketë etiketën e eficiencës së energjisë dhe të ndalohet importi i produkteve jo eficiente dhe produkteve pa etiketë.

17. Furnizimi i administratës qendrore dhe lokale vetëm me pajisjet nga ky inventar pajisjesh.

18. Mirëmbajtja dhe aktualizimi i vazhdueshëm i uebfaqeve të institucioneve me informata mbi masat e aplikuar të EE dhe projektet e planifikuara.

19. Të ketë staf të mjaftueshëm profesional (arkitektë, inxhinierë, teknikë, auditorë të energjisë etj.).

20. Të ofrojë shërbime të Energjisë (ESCO) dhe të angazhojë ESCO private për arritjen e caqeve.

9. Rezyme

Shfrytëzimi i potencialit të madh të kursimit të energjisë, sidomos në sektorin e ndërtimit, duhet të ketë prioritet të lartë te autoritetet publike të cilat duhet të jenë fleksibile dhe inovative kur bëhet fjalë adresimi i sfidave në sektorin e energjisë në Kosovë. Gjatë hulumtimit, është vërejtur se Kosova stagnon në shfrytëzimin e këtij potenciali për arsye të natyrave të ndryshme si: mosharmonizimi i ligjeve, paqartësia në shpërndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve publike, mungesa e ekspertëve si dhe mungesa e mjeteve financiare, dhe që si pasojë ka mungesën e blerjes së pajisjeve, ndërtesave, shërbimeve me performancë të lartë energjetike dhe mungesën e kontraktimit të kompanive për shërbime të energjisë (ESCO).

Ky hulumtim – në mënyrë që të arrihen objektivat në fushën e efijencës së energjisë - rekomandon që së pari të bëhet ndryshimi, respektivisht amandamentimi i kornizës ekzistuese ligjore (LPP, LEE, LPPP, LPEN, etj.), dhe pastaj implementimi dhe monitorimi i saj. Një gjë e tillë bëhet me ndarjen e saktë të detyrave dhe kompetencave të institucioneve duke krijuar dy institucione themelore të energjisë, ku njëri do ketë karakter legjislativ që bënë hartimin, përpilimin, kontrollimin e implementimit të ligjeve, ndërsa tjetri do të ketë karakter zbatues që bënë ekzekutimin e masave të EE duke u thirrur në ligjet që hartohen nga institucioni legjislativ. Këto institucione duhet të posedojnë stafin me ekspertë dhe të financohen nga ministria përgjegjëse.

Andaj, autoritetet publike duhet të angazhohen maksimalisht në largimin e barrierave ekzistuese për aplikimin e masave të efijencës së energjisë dhe të fuqizojnë dhe shumëfishojnë përdorimin tyre, në mënyrë që sektori i efijencës së energjisë të zhvillohet dhe stabilizohet njëherë e përgjithmonë që të sjellë të mira dhe përfitime në aspektin mjedisor, ekonomik e social në vend.

10. Referenca

1. Ligji nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. (2008). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>
2. Ligji nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. (2011). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>
3. Ligji nr. 04/L-045 Për Partneritet Publiko Privat. (2011). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784>
4. Ligji nr. 05/L-101 Për Performancën Energjetike në Ndërtesa. (2016). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13176>
5. Ligji nr. 06/L-079 Për Efijencë të Energjisë. (2018). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18216>
6. Ligji nr. 03/L-175 Ligji për Borxhet Publike. (2010). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2663>
7. Ligji nr. 05/L-084 I Rregullatorit të Energjisë
8. Zyra e Rregullatorit për Energji, ZRRE (Maj, 2020). Intervistë nga Balkan Green Foundation.
9. Agjencia e Kosovës për Efijencë të Energjisë, AKEE (Maj, 2020). Intervistë nga Balkan Green Foundation.
10. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, GIZ (Maj, 2020). Intervistë nga Balkan Green Foundation.
11. Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë, FKEE (Qershor, 2020). Intervistë nga Balkan Green Foundation.
12. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, MZHE (Qershor, 2020). Intervistë nga Balkan Green Foundation.
13. Ilaz Duli (Qershor, 2020). Intervistë nga Balkan Green Foundation.
14. Directive 2012/27/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 on Energy Efficiency, amending Directives 2009/125/EC and 2010/30/EU and repealing Directives 2004/8/EC and 2006/32/EC. (2012). Official Journal of the European Union.

15. Panev, S., Bertoldi, P., Boza-Kiss, B., Palermo, V., *Report for Development of the ESCO Market in the EU Enlargement and Neighbouring Countries*, EUR 28405 EN, Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2018, 978-92-79-64960-8, doi:10.2760/36626, JRC104394.
16. Joint Research Center, *E3P - European Energy Efficiency Platform. Energy performance contracting*. <https://e3p.jrc.ec.europa.eu/articles/energy-performance-contracting>
17. Energy Community Secretariat. (2019). *Annual Implementation Report*.
18. Energy Community Secretariat. *Gaps and Recommendations for ESCO in Kosovo*.
19. *Financimi i Eficiencës së Energjisë në Kosovë – Përfitimet dhe Pengesat -INDEP*
20. *Plani Kombëtar i Veprimtërisë për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (PKVBRE)_2011-2020*
21. *Economic Reform Programme 2019-2021*
22. *Projekt-Udhëzim-Administrativ-MZHE-Nr.-XX2019-për-Kërkesat-për-Eficiencë-të-Energjisë*
23. *Projekt Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr. XX/2019 për Kërkesat për Eficiencë të Energjisë për Blerjen e Produkteve, Shërbimeve dhe Ndërtesave nga Institucionet e Nivelit Qendror*
24. *Raporti i Auditorit - Projekti për Eficiencë*
25. *Balanca afatgjate e energjisë e Republikës së Kosovës 2015-2024 shqip (MZHE)*
26. *Komiza e Menaxhimit të Mjedisit për Projektin e Eficiencës së Energjisë dhe Energjisë Ripërtërishme në Kosovë (MZHE)*
27. *National Programme for Implementation of the Stabilisation and Association Agreement (NPISAA), (2016, March), Republic of Kosovo. http://mei-ks.net/repository/docs/3_pkzmsa_miratuar_nga_kuvendi_final_eng_.pdf*

